



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin qershor 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin e muajit qershor 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në muajin qershor, vijuar takimet me grupin e punës për projektligjin “Mbi Zhvillimin dhe Mbështetjen e Start Up-eve Inovative”. Së bashku me ekspertët po përmirësojmë kuadrin ligjor duke identifikuar incentivat më të përshtatshme për tu implementuar në Shqipëri me qëllim krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm për lindjen dhe rritjen e start up-eve në Shqipëri. Gjithashtu gjatë Ditës së Bizneseve Sociale, me anë të një webinar-i online patëm mundësinë të ndajmë me studentë të fushave të ndryshme të universiteteve, risitë që po përgatisim në lidhje me start up-et inovative, duke i kërkuar përfshirjen e tyre për çdo koment apo sugjerim.

Me anë të kontaktit të drejtpërdrejtë me shoqatat dhe dhomat e tregtisë në vend, si dhe me biznese individuale, u vumë në dijeni mbi vështirësitë e biznesit për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, veçanërisht në lidhje me implementimin e fiskalizimit brenda afateve ligjore të përcaktuara. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u mundësua shtyrja e afatit të fillimit të implementimit të procesit të fiskalizimit për të krijuar mundësinë që sipërmarrja të ketë kohën e duhur për përgatitjen e sistemeve dhe të stafit të tyre. Ndërkohë kemi vijuar në mënyrë intensive vizitat në sipërmarrje, gjatë të cilave ndajmë shqetësimet e biznesit përse i përket lehtësimit të procedurave në institucione të ndryshme.

Kemi ndjekur me prioritet punën e rrjetit të koordinatorëve të dedikuar për biznesin, duke pasur takime si me koordinatorët e Ministrive por edhe të institucioneve kryesore. Gjatë këtyre takimeve, u theksua rëndësia e trajtimit dhe gjurmimit të çështjeve deri në zgjidhjen e tyre, si dhe përpilimin e raporteve periodike, të cilat na ofrojnë një perspektivë më të qartë të tipologjive të problematikave më të shpeshta të hasura nga bizneset. Duke mbajtur kontakt të vijueshëm dhe me anë të gjurmimit të ankesave, jemi në gjendje të ofrojmë zgjidhje afatgjata për sipërmarrjen, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit.


Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi




Analiza e Ankesave Qershor 2020


1. Shperndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

